



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 042255528



KONTRATA TË TJERA

Nr. repertori: 9986

Nr. koleksioni: 4214

Tirane më 03/11/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 15 fletë.



A2023053950472810257



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

REP.

KOL.



A2023053950472810257

MARRËVESHJE BASHKIMI ME PËRTHITHJE

DATË 03 NËNTOR 2023

ndërmjet

American Hospital SH.A.

si Shoqëria Përthithëse

dhe

International Hospital SH.A.

si Shoqëria e Përthithur



A2023053950472818257

PROJEKT MARRËVESHJE

BASHKIMI ME PËRTHITHJE

Sot, më datë 3 nëntor 2023, para meje Noter JULLAN ZHELEGU, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjetër Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqitën personalisht:

1. **American Hospital SH.A.**, një shoqëri aksionare shqiptare, themeluar më 17.02.2006, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (“**QKB**”) më 17.02.2006, me NUIS K61821002C, me seli në njësia bashkiake nr. 6, rruga “Sabaudin Gabrani”, godina nr. 2, zona kadastrale 8240, pasuria nr. 2/154, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori **Klodian Allajbeu**, atësia Fadil, amësia Myrvetë, shtetas Shqiptar, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, me adresë Dëshmorët E 4 Shkurrit; Nd. Nd.58; H. D; Ap. 221; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 21/04/1978, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036753569 dhe nr. personal H80421164I, i përfaqësuar në baze të prokurës së përgjithshme me nr. 8736 rep, nr. 2973 kol, datë 8.12.2022 e noter Valbona Sh. Selimi, nga **Onejda Ymeraj**, atësia Fadil, amësia Zhaneta, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në TIRANË, me adresë Ymer Kurti; Nd. 13; H. 5; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 30/05/1985, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038841981 dhe nr. personal I55530051B, (“**American Hospital**” ose “**Shoqëria Përthithëse**”),

dhe

2. **International Hospital SH.A.**, një shoqëri aksionare shqiptare, themeluar më 25.04.2007, regjistruar pranë QKB më 22.05.2007, me NUIS K71822007C, me seli në Tiranë, Kashar, Mezez, km 01 i Rrugës dytësore të Autostradës Tiranë-Durrës, Fushë-Mezez, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori Mario Karaj, atësia Ruzhdi, amësia Mukades, shtetas Shqiptar, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, me adresë Ndre Mjeda; Nd. 5; H. 5; Ap. 25; Njësia Administrative Nr. 7; Tiranë 7; 0000; Tiranë, lindur më 24/10/1982, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033763830 dhe nr. personal I21024050G, (“**International Hospital**” ose “**Shoqëria e Përthithur**”).

Këtu dhe më poshtë, American Hospital dhe International Hospital janë quajtur individualisht “**Pala**” dhe bashkërisht “**Palët**”.



A2023053950472810257

Tabela e Përmbajtjes

Lista e Shtojcave	4
Deklarata Paraprake	6
Neni 1 Përkufizime dhe Interpretime.....	7
Neni 2 Bashkimi me Përthithje	9
Neni 3 Bilancet në Mbyllje; Data e Ekzekutimit	9
Neni 4 Aktivet e Transferuara.....	10
Neni 5 Kushtet Paraprake të Mbylljes.....	11
Neni 6 Mbyllja	11
Neni 7 Aksionet	12
Neni 8 Shoqëria; Përparësitë e Veçanta dhe Përfitimet.....	12
Neni 9 Mbrojtja e Kreditorëve	13
Neni 10 Pasojat për të Punësuarit.....	13
Neni 11 Zgjidhja e Marrëveshjes.....	13
Neni 12 Ligji i Zbatueshëm	13
Neni 13 Të Ndryshme.....	13



A2023053950472810257

Lista e Shtojcave

Në datën e Nënshkrimit:

Neni	Shtojca
Deklarata Paraprake (A)	Shtojca 1: Ekstrakti i Regjistrit Tregtar të American Hospital.
Deklarata Paraprake (B)	Shtojca 2: Ekstrakti i Regjistrit Tregtar të International Hospital.
Neni 3.2	Shtojca 3: Bilancet e American Hospital dhe International Hospital të Datës së Fundit Kontabël.
Neni 3.3	Shtojca 4 : Bilanci i Hapjes së Bashkimit me Përthithje.

Në datën e Mbylljes:

Neni	Shtojca
Neni 3.6	Shtojca 5: Raporti i Drejtorëve të American Hospital dhe International Hospital.
Neni 4.3.i	Shtojca 6: Listë e markave, patenta, know how dhe të drejta të tjera mbi pronësinë intelektuale të International Hospital.
Neni 4.3.ii	Shtojca 7: Listë e Pasurive të paluajtshme të International Hospital.
Neni 4.3.iii	Shtojca 8: Licencat e International Hospital dhe të drejta të ngjashme.
Neni 4.3.iv	Shtojca 9: Listë e kontratave të International Hospital.
Neni 4.3.vi	Shtojca 10: Listë e çështjeve gjyqësore në zhvillim.



A2023053950472810267



Neni 10.2

Shtojca 11: Statuti i ndryshuar i American Hospital

Shtojca 12: Lista e anëtarëve të organeve të administrimit të American Hospital. Shtojca 13: Dorëheqjet e anëtarëve të organeve të International Hospital.

Shtojca 14: Listë e kontratave të punës.



A2023053950472810257

DEKLARATA PARAPRAKE :

- (A) American Hospital, një shoqëri aksionare shqiptare që ofron shërbime në fushën e shëndetësisë, themeluar më 17.02.2006, regjistruar pranë QKB-së me 17.02.2006, me NUIS K61821002C, e cila ka një kapital aksionar të barabartë me 2,907,200,000.00 Lekë të përbërë nga 290720 aksione, me një vlerë nominale 10,000 Lekë secila, të zotëruara 100% nga aksionari i vetëm Balkan Alliance Healthcare B.V, e përfaqësuar nga Z. Klodian Allajbeu, në cilësinë e administratorit. Të dhënat e American Hospital bashkëngjiten si *Shtojca 1*.
- (B) International Hospital, një shoqëri aksionare shqiptare e cila gjithashtu ofron shërbime në fushën e shëndetësisë, themeluar në 25.04.2007, regjistruar pranë QKB-së më 22.05.2007, me NUIS K71822007C, e cila ka një kapital aksionar të barabartë me 4,063,156,463 Lekë të përbërë nga 9651203 aksione, me një vlerë nominale 421 Lekë secila, të zotëruara 100% nga aksionari i vetëm American Hospital, e përfaqësuar nga Z. Mario Karaj, në cilësinë e administratorit. Të dhënat e International Hospital bashkëngjiten si *Shtojca 2*.
- (C) American Hospital dhe International Hospital do të integrohen nga ana ligjore dhe organizative në një person juridik të vetëm ("**Transaksioni i Bashkimit**"). Qëllimi është rritja e performancës, optimizimi i burimeve njerëzore dhe përfundimi i një efekti sinergjik, ulja e kostove, rritja e numrit të klientëve/pacientëve, përmirësimi i shërbimeve të ofruara klientëve/pacientëve, shtimi i investimeve, dhe si rezultat rritja e të ardhurave.
- (D) Duke filluar nga data e nënshkrimit deri në Mbylljen e Transaksionit të Bashkimit, American Hospital dhe International Hospital do të jenë në periudhën kalimtare ("**Periudha Kalimtare**"); gjatë kësaj periudhe do të ndërmerren hapa të ndryshëm drejt bashkimit të strukturës së burimeve njerëzore si dhe konsolidimit të drejtimit.
- (E) Kjo Marrëveshje rregullohet sipas ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Mbi Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ("**Ligji Tregtar**"), Kapitulli IX. Në veçanti, Neni 225 paragrafi 2 i Ligjit Tregtar i zbatohet kësaj Marrëveshjeje.
- (F) Palët kanë vendosur të hyjnë në këtë Marrëveshje në mënyrë që të përcaktojnë kushtet e detyrimeve dhe të drejtave të tyre përkatëse në lidhje me Transaksionin e Bashkimit.

6



A2023053950472810257

PALET BIEN DAKORT MBI SA MË POSHTË:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1. Në këtë Marrëveshje (duke përfshirë deklaratat paraprake dhe shtojcat bashkëlidhur), përveç rasteve kur kërkohet ndryshe nga konteksti ose përcaktohet ndryshe në vazhdim, fjalët e renditura më poshtë kanë këto kuptime:

“AK” do të thotë Autoriteti i Konkurrencës në Republikën e Shqipërisë;

“Aktivet dhe Pasivet Transferuara” do të thotë të gjitha aktivet dhe pasivet e transferuara nga shoqëria e përthithur (International Hospital) drejt shoqërisë përthithëse (American Hospital), siç është përkthyer në nenin 4 më poshtë;

“American Hospital” ose “Shoqëria Përthithëse” do të thotë American Hospital Sh.A, një shoqëri aksionare shqiptare që ofron shërbime në fushën e shëndetësisë, themeluar më 17.02.2006, regjistruar pranë QKB me 17.02.2006, me NUIS K61821002C, e cila ka një kapital aksionar të barabartë me 2.907.200.000,00 Lekë të përbërë nga 290.720 aksione, me një vlerë nominale 10.000 Lekë secila, të zotëruara 100% nga aksionari i vetëm Balkan Alliance Healthcare B.V, e përfaqësuar nga Z. Klodian Allajbeu, në cilësinë e administratorit.

“Bilanci i Hapjes së Bashkimit me Përthithje” do të thotë Bilanci i Hapjes i Shoqërisë Përthithëse në Datën e Ekzekutimit, që do të bazohet në bilancin e konsoliduar të Datës së Fundit Kontabël të të dyja shoqërive, përpara Përthithjes.

“Data e Ekzekutimit” do të thotë data e regjistrimit të Mbylljes në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në përputhje me nenin 3.1.;



K2023053950472810257



“Data e Fundit Kontabël”	do të thotë data 31 gusht 2023.
“Data e Mbylljes”	do të thotë data në të cilën do të kryhet Mbyllja në përputhje me nenin 6.1.;
“Data e Mbylljes Kontabël”	do të thotë 1 Janar 2024, sipas nenit 3.5.
“Data e Nënshkrimit”	do të thotë data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.
“International Hospital” ose “Shoqëria e Përthithur”	do të thotë International Hospital SH.A, një shoqëri aksionare shqiptare, themeluar më 25.04.2007, regjistruar pranë QKB më 22.05.2007, me NUIS K71822007C, aksionet e së cilës zotërohen 100% nga American Hospital dhe janë të lira nga pretendimet e palëve të treta;
“Kodi i Punës”	do të thotë Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
“Ligji Tregtar”	do të thotë Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar;
“Marrëveshja”	do të thotë kjo Marrëveshje Bashkimi me Përthithje - duke përfshirë si pjesë integrale të saj deklaratat paraprake dhe shtojcat bashkëngjitur, bazuar në nenin 216 të Ligjit Tregtar;
“Mbyllja”	do të thotë mbyllja e bashkimit mes American Hospital dhe International Hospital, si edhe me gjerësisht, nënshkrimi dhe shkëmbimi i të gjitha dokumenteve dhe përmbushja e plotësimi të gjitha detyrimeve përkatëse që kërkohen të nënshkruhen, shkëmbehen, kryen dhe konsumohen në Mbyllje sipas neneve 5 dhe 6 të kësaj Marrëveshjeje;



A2023053950472810257

“Periudha Kalimtare”



do të thotë periudha kohore nga data e Nënshkrimit deri në Mbylljen e Transaksionit të Bashkimit me Përthithje, gjatë së cilës American Hospital dhe International Hospital do të kryejnë një tërësi veprimesh me qëllim përmbushjen e transaksionit të Bashkimit me Përthithje;

“Regjistri Tregtar”

do të thotë Regjistri Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit;

“QKB”

do të thotë Qendra Kombëtare e Biznesit.

1.2. Në këtë Marrëveshje (duke përfshirë deklaratimet dhe shtojcat bashkëlidhur), përveç rasteve kur kërkohet ndryshe nga konteksti ose përcaktohet ndryshe në vazhdim:

(i) referimet ndaj Neneve konsiderohen referime ndaj neneve të kësaj Marrëveshjeje dhe referimet ndaj Shtojcave, konsiderohen referime ndaj Shtojcave të kësaj Marrëveshjeje;

(ii) titujt e neneve dhe Shtojcave janë vendosur për lehtësi në lexim dhe nuk ndikojnë në asnjë rast në interpretimin e Marrëveshjes së Bashkimit me Përthithje;

(iii) çdo dokument bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje Bashkimi me Përthithje, duke përfshirë Shtojcat, përbën pjesë të pandashme të kësaj Marrëveshjeje dhe ka të njëjtën fuqi ligjore dhe efekt si ajo.

2. BASHKIMI ME PËRTHITHJE

2.1. International Hospital do të përthithet nga American Hospital sipas kushteve e kësaj Marrëveshjeje, hartuar në përputhje me nenin 216 dhe 225 paragrafi 2 i Ligjit Tregtar.

2.2. Bazuar në Nenin 215, paragrafi 1 të Ligjit Tregtar, International Hospital do të transferojë me anë të Bashkimit me Përthithje, të gjitha aktivet dhe pasivet që zotëron. Transferimi sjell pasoja si ndërmjet Palëve edhe te palët e treta (220 paragrafi 3 a) i Ligjit Tregtar).

3. BILANCET NË MBYLLJE; DATA E EKZEKUTIMIT

3.1. Përthithja do të kryhet me efekt *in rem*, në datën e regjistrimit të Mbylljes së Bashkimit me Përthithje në Regjistrin Tregtar (“**Regjistri Tregtar**”) pranë QKB, në përputhje me nenin 220, paragrafi 3 të Ligjit Tregtar (“**Data e Ekzekutimit**”).



A2023053950472810257

3.2. Bashkimi me Përthithje do të bazohet në bilancet e International Hospital dhe American Hospital të datës 31 gusht 2023 (“**Data e Fundit Kontabël**”). Bilancet sipas Datës së Fundit Kontabël i janë bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje si *Shtojca 3*.

3.3. Bilanci i Hapjes i Shoqërisë Përthithëse në Datën e Ekzekutimit, do të bazohet në bilancin e konsoliduar të Datës së Fundit Kontabël të të dyja shoqërive, përpara Përthithjes (“**Bilanci i Hapjes së Bashkimit me Përthithje**”). Bilanci i Hapjes së Bashkimit me Përthithje, i është bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje si *Shtojca 4*.

3.4. Në përputhje me nenin 220, paragrafi 3 gërma c) të Ligjit Tregtar, International Hospital do të vlerësohet e prishur dhe do të çregjistrohet nga QKB, pa kaluar në procesin e likuidimit.

3.5. Pavarësisht nga Data e Ekzekutimit, në kuptim të nenit 216, paragrafi 1 gërma d) të Ligjit Tregtar, veprimet e Shoqërisë së Përthithur do të trajtohen nga pikëpamja kontabël dhe tatimore si veprime të Shoqërisë Përthithëse duke filluar (dhe përfshirë) nga data 1 janar 2024 (“**Data e Mbylljes Kontabël**”).

3.6. Çdo ndryshim dhe korigjim i mundshëm i kryer midis Datës së Fundit Kontabël, Datës së Ekzekutimit dhe Datës së Mbylljes Kontabël, i cili nuk është përfshirë në *Shtojcën 4*, do të pasqyrohet në raportin e drejtorit të American Hospital sipas nenit 216 paragrafi 6 i Ligjit Tregtar, i cili do të bashkëngjitet në Mbyllje si *Shtojca 5* dhe në Pasqyrat Financiare për vitin 2024.

4. AKTIVET E TRANSFERUARA

4.1. Në përputhje me nenin 215, paragrafi 1 të Ligjit Tregtar, International Hospital do të transferojë si pasojë e Bashkimit me Përthithje, të gjitha aktivet e qëndrueshme materiale dhe jomateriale, të paraqitura në formën e aktiveve dhe pasiveve, duke përfshirë marrëdhëniet kontraktore dhe marrëdhënie të tjera juridike, të arkëtueshme dhe detyrime, detyrime të mundshme, të arkëtueshme të ardhshme, dhe me kusht (“**Aktivitet dhe Pasivitet e Transferuara**”).

4.2. Aktivitet dhe Pasivitet e Transferuara janë përcaktuar në Bilancin e Datës së Fundit Kontabël në *Shtojcën 3*.

4.3 Aktivitet dhe Pasivitet e Transferuara përfshijnë në veçanti (por pa u kufizuar):

(i) çdo markë, dizeno, patentë, *know how* dhe të drejta të tjera të pronësisë intelektuale të International Hospital, siç janë përcaktuar në *Shtojcën 6* (bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje në Datën e Mbylljes);



(ii) të gjitha pronat e paluajtshme të International Hospital sipas renditjes në *Shtojcën 7* (për t'ju bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje në Datën e Mbylljes);

(iii) çdo licencë dhe e drejtë e ngjashme të International Hospital sipas renditjes në *Shtojcën 8* (për t'ju bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje në Datën e Mbylljes);

(iv) të gjitha kontratat sipas renditjes në *Shtojcën 9* (për t'ju bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje në Datën e Mbylljes);

(v) të gjitha detyrimet sipas renditjes në Bilancin e Datës së Fundit Kontabël;

(vi) një listë e konflikteve të pazgjidhura do t'i bashkëngjiten kësaj Marrëveshjeje në Datën e Mbylljes si *Shtojca 10*.

4.4. Nëse për transferimin e aktiveve të caktuara nevojitet miratimi nga ana e një kreditori ose palë të tretë, American Hospital ose International Hospital do të bëjnë të mundur marrjen e këtij miratimi, në përputhje me nenin 5.1.4. më poshtë.

5 KUSHTET PARAPRAKE TË MBYLLJES

5.1. Përfundimi i plotë i Transaksionit të Bashkimit i nënshtrohet përmbushjes së kushteve të mëposhtme përpara Mbylljes:

5.1.1. Asamblatë e Përgjithshme të Aksionarëve të American Hospital dhe të International Hospital duhet të kenë miratuar këtë Marrëveshje dhe dokumentet e tjera në lidhje me të, në përputhje me nenin 218 të Ligjit Tregtar.

5.1.2 Asamblatë e Përgjithshme të Aksionarëve të American Hospital dhe të International Hospital duhet të mbledhen të paktën një muaj pas publikimit të kësaj Marrëveshjeje në QKB, në përputhje me nenin 216, paragrafi 3 i Ligjit Tregtar.

5.1.3. AK duhet të këtë aprovuar Transaksionin e Bashkimit, nëse ky miratim është ligjërish i nevojshëm.

5.1.4. Palët duhet të kenë marrë të gjitha miratimet e palëve të treta, nëse ka të tilla ligjërish ose kontraktualisht të nevojshme.

6 MBYLLJA

6.1. Mbyllja do të realizohet pranë selisë së American Hospital, sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur pas përmbushjes së kushteve paraprake të Mbylljes, ose mund të realizohet në një vend



AZ023053950472810257

dhe kohë tjetër të konsideruar nga Palët si të përshtatshme dhe mbi të cilat bien bashkërisht dakord.

6.2. Deri në, ose në Datën e Mbylljes, palët duhet të bëjnë të mundur që dokumentet e mëposhtme të ekzekutohen dhe dorëzohen si më poshtë:

(i) Marrëveshja përfundimtare e Bashkimit me Përthithje;

(ii) një kopje e vërtetuar e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të American Hospital, gjatë së cilës janë miratuar Mbyllja e Transaksionit të Bashkimit me Përthithje, Marrëveshje e Bashkimit me Përthithje dhe dokumentet e tjera në lidhje me të;

(iii) një kopje e vërtetuar e Statutit të Shoqërisë Përthithëse, të ndryshuar;

(iv) Të gjitha Shtojcat e renditura në Listën e Shtojcave, për t'u bashkëngjitur në Datën e Mbylljes.

6.3. Në Mbyllje, American Hospital do të marrë në posedim të gjithë librat, korrespondencën, të dhënat operative dhe regjistrime të tjera tregtare të mbajtura nga International Hospital.

6.4. Menjëherë pas Mbylljes, American Hospital do të regjistrojë pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme çdo të drejtë pronësie që transferohet nga International Hospital drejt American Hospital si pasojë e Transaksionit të Bashkimit.

6.5. Menjëherë pas Mbylljes, American Hospital do të regjistrojë pranë autoriteteve kompetente markat e International Hospital në emër të tij.

7. AKSIONET

7.1. Çdo aksion i International Hospital i zotëruar nga American Hospital, nuk do të ekzistojë më si pasojë e Transaksionit të Bashkimit, pa qenë e nevojshme kryerja e ndonjë veprimi nga ana e American Hospital.

8. SHOQËRIA; PËRPARËSITË E VEÇANTA DHE PËRFITIMET

8.1. Statuti i American Hospital, i ndryshuar dhe miratuar rregullisht në Mbyllje, do të konsiderohet Statuti i Shoqërisë Përthithëse, dhe bashkëngjitet si *Shtojca 11*.

8.2. Në datën e Mbylljes, anëtarët e organeve të shoqërisë American Hospital do të jenë si përshkruhen në *Shtojcën 12*. Anëtarët e Këshillit të Administrimit të International Hospital do të japin dorëheqjen në Datën e Mbylljes (dorëheqjet bashkëngjitur si *Shtojca 13*).



8.3. Nuk janë dhënë përfitime të veçanta.

9. MBROJTJA E KREDITOREVE

9.1. Kreditoret e International Hospital mbrohen në përputhje me nenin 221 të Ligjit Tregtar.

10. PASOJAT PËR TË PUNËSUARIT

10.1. Pasojat e Përthithjes në lidhje me punonjësit e International Hospital do të përcaktohen në përputhje me nenin 138 dhe 139 të Kodit të Punës.

10.2. Në Datën e Ekzekutimit, çdo kontratë pune e International Hospital që është në fuqi do të transferohet sipas ligjit tek American Hospital, në përputhje me nenin 138, paragrafi 1 të Kodit të Punës. American Hospital do të marrë përsipër kontratat e punës të punëmarrësve të transferuar së bashku me gjitha të drejtat dhe detyrimet. Kjo nënkupton veçanërisht, se të gjitha periudhat e punës së kryer ose të njohura nga International Hospital, do të konsiderohen si punë e kryer në American Hospital. Palët konsiderojnë se kontratat e punës të përcaktuara në *Shtojcën 14*, bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje mbulohen nga ky nen.

11. ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

11.1. Kjo Marrëveshje mund të zgjidhet në çdo kohë përpara Datës së Mbylljes, me miratimin e dhënë me shkrim nga të dyja Palët.

12. LIGJI I ZBATUESHËM

12.1. Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve dhe akteve të tjerë me fuqinë e ligjit që zbatohet në Republikën e Shqipërisë.

12.2. Gjykata kompetente për shqyrtimin e konflikteve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

13. TË NDRYSHME

13.1. Shpenzimet

American Hospital do të marrë përsipër shpenzimet në lidhje me negocimet, zbatimin dhe Mbylljen e çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për Përthithjen.



A2023053950472810257

13.2. Tërësia e Marrëveshjes.

Kjo Marrëveshje (bashkë me dokumentet tek të cilat referon ose që janë zbatuar përpara ose në momentin e Mbylljes) përbën Marrëveshjen në tërësi dhe marrëveshjen mes Palëve, zëvendëson dhe ka përparësi ndaj çdo marrëveshjeje, rregullimi apo ndërmarreje të mëparshme të Palëve në lidhje me këtë çështje.

13.3. Ndryshimet në Marrëveshje

Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje do të jetë i vlefshëm vetëm nëse është bërë me shkrim dhe është nënshkruar nga Palët.

13.4. Pavlefshmëria e pjesshme

Në rast se një pjesë e kësaj Marrëveshjeje është/ose shpallet e pavlefshme ose jodetyruese, pjesa tjetër mbetet e vlefshme dhe detyruese për Palët. Në këtë rast, Palët zëvendësojnë dispozitat e pavlefshme ose jodetyruese me dispozita të vlefshme dhe detyruese, efekti i të cilave, për aq sa është e mundur, është sa më i afërt me dispozitat e pavlefshme ose jodetyruese duke pasur parasysh përmbajtjen dhe qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

13.5. Gjuha

Kjo Marrëveshje është hartuar në shqip.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave që u paraqitën para meje, si dhe zotësinë e tyre për të kuptuar dhe vepruar, si edhe të drejtat për të përfaqësuar palët e kësaj kontrate, lexoj më zë të lartë tekstin e kësaj kontrate, dhe palët e përfaqësuesit e palëve, deklarojnë se e gjejnë këtë kontratë në përputhje me vullnetin e tyre e të lirë e të plotë, dhe me të drejtat e dhëna, dhe e nënshkruajnë rregullisht atë dhe unë, Noteri e vërtetoj sipas ligjit.

Tiranë, më 03 nëntor 2023, në 5 (pesë) kopje origjinale.

[PJESA E MBETUR LËNË QËLLIMISHT BOSH

FAQJA E NËNSHKRIMIT VIJON]



A2023053950472810257

Nënshkruar nga:



PËR AMERICAN HOSPITAL SH.A.

-) Administratori
-) Z. Klodian Allajbeu
-)
-) Përfaqësuar me prokurë nga
-) Znj. Onejda Ymeraj
-)

ONEJDA YMERAJ



PËR INTERNATIONAL HOSPITAL SH.A.

-) Administratori
-) Z. Mario Karaj
-)
-)
-)
-)
-)
-)

MARIO KARAJ



NOTERI

-) Z. Julian Zhelegu
-)
-)
-)
-)
-)
-)
-)



SHTOJCA 1

Ekstrakti i Regjistrit Tregtar të American Hospital



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI AKSIONARE”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	K61821002C			
2. Data e Regjistrimit	17/02/2006			
3. Emri i Subjektit	AMERICAN HOSPITAL			
4. Forma ligjore	Shoqëri Aksionare			
5. Data e themelimit	17/02/2006			
6. Kohëzgjatja	Nga: 17/02/2006 Deri:			
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia bashkiake nr 6, rruga Sabaudin Gabrani, godina nr 2, zona kadastrale 8240, pasuria nr 2/154			
8. Kapitali	2.907.200.000,000			
9. Vlera e kapitalit të shlyer:	2907200000.0000			
10. Numri i aksioneve:	290.720,000			
10.1 Vlera nominale:	10.000,000			
11. Kategoritë e aksioneve të shoqërisë	të zakonshme	me përparësi	me të drejte vote	pa të drejte vote
11.1 Numri për secilën kategori				
12. Objekti i aktivitetit:	Investime dhe shërbime në fushën e mjeksisë dhe shëndetit, ngritja dhe menaxhimi i spitaleve dhe klinikave private, importimi dhe eksportimi i materialeve të ndryshme. Industria e ndertimit, shit-			



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	blerje, dhenie ose marrje me qera. Riparim i paisjeve dhe puneve obliguese ne montim. Pergatitje projektesh. Konsulence teknike ne fushen e ndertimit dhe fusha te tjera., projektimi i pyjeve, etj. Tregtim me shumice te aparaturave mjeksore/pajisje, tregtim me pakice i barnave. Aktivitetet ne fushen e sherbimeve te lavanderise (duke perfshire larje / tharje / palosje, marrje dhe dorezim) per entitetet private ose publike (te tilla si, duke perfshire por pa u kufizuar tek spitalet, infrastrukture mjekesore, industri te ndryshne, etj), import-eksport te materialeve dhe makinerive qe lidhen me fushen e sherbimeve te lavanderive, si dhe cdo aktivitet tjetër ne sherbim te fushave te aktivitetit te mesiperm.	
13. Sistemi i administrimit	<input type="checkbox"/> me një nivel <input checked="" type="checkbox"/> me dy nivele	
14. Administratori/ët	Klodian Allajbeu	
14.1 Afati i emërimit	Nga: 07/06/2017	Deri: 31/12/2023
15. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore. 15.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka).		
16. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)	David Lyle Mathewson	
16.1 Kryetar/anëtar	Anetar	
16.2 Afati i emërimit	Nga: 01/01/2021	Deri: 31/12/2023
17. Anëtar i Pavarur	Jo	
17.1 Përfaqesues i Punëmarrësve	Jo	
17.2 Kushtet e pjesëmarrjes		
18. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
19. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)	Klodian Allajbeu	
19.1 Kryetar/anëtar	Anetar	
19.2 Afati i emërimit	Nga: 01/01/2021	Deri: 31/12/2023
20. Anëtar i Pavarur	Po	
20.1 Përfaqesues i Punëmarrësve	Jo	
20.2 Kushtet e pjesëmarrjes		
21. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

22. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele) 22.1 Kryetar/anëtar 22.2 Afati i emërimit	Catalin-Mihai Iliescu	
	Anetar	
	Nga: 01/01/2021	Deri: 31/12/2023
23. Anëtar i Pavarur 23.1 Përfaqesues i Punëmarrësve 23.2 Kushtet e pjesëmarrjes	Jo	
	Jo	
24. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
25. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele) 25.1 Kryetar/anëtar 25.2 Afati i emërimit	Ercan Nuri Ergul	
	Anetar	
	Nga: 01/03/2022	Deri: 31/12/2023
26. Anëtar i Pavarur 26.1 Përfaqesues i Punëmarrësve 26.2 Kushtet e pjesëmarrjes	Po	
	Jo	
27. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
28. Eksperti/ët Kontabël i Autorizuar 28.1 Afati i emërimit	Paqsor Qato	
	Nga: 17/02/2006	Deri:
29. Eksperti/ët Kontabël i Autorizuar 29.1 Afati i emërimit	PricewaterhouseCoopers Audit	
	Nga: 20/11/2018	Deri:
30. Aksionarët 30.1 Numri i Aksioneve 30.2 Përqindja e pjesëmarrjes	Balkan Alliance Healthcare B.V	
	Me te drejte vote: 290720.0000 Pa te drejte vote:	
	100,000	
31. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Shkoder Shkoder SHKODER Lagjja Skenderbeg, Nr. pasurie 12/401, Zona Kadastrale 8593 Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.11, Rr.Lord Bajron, prane S.U.T (Spitalit Ushtarak i Traumes) Okulistika ne Spitalin Amerikan Nr.1 Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr. 4, Rruga Bajram Curri, prane Fakultetit te Mjekesise, Receptioni Kryesor ne Spitalin Amerikan Nr. 2.	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

<p>Tirane Kamez KAMEZ Lagjja Nr.4, Rruga Venecia, Godina Nr.10</p> <p>Tirane Tirane TIRANE , Njësia Bashkiake Nr. 4, Rr. "Bajram Curri", pranë Fakultetit të Mjekësisë, Hemodializa në Spitalin Amerikan Nr. 2.</p> <p>Gjirokaster Gjirokaster GJIROKASTER Ndërtesa shtatë katëshe, e ndodhur ne Lagjja "18 Shtatori", me numër pasurie 16/83 (N1), Zona Kadastrale 8541</p> <p>Tirane Tirane TIRANE Njësia Bashkiake Nr.4, Rr. "Bajram Curri", pranë Fakultetit të Mjekësisë, Gjinekologjia në Spitalin Amerikan Nr. 2</p> <p>Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.11, Rr.Lord Bajron, prane S.U.T (Spitalit Ushtarak i Traumes) Kardiokirurgjia ne Spitalin Amerikan Nr.1</p> <p>Fier Fier FIER Lagjja 1 Maji, rruga Cameria, perballe Spitalit Rajonal Fier, Magazina</p> <p>Tirane Tirane TIRANE Njësia Bashkiake Nr.4, Rr. "Selaudin Zorba" Nr.61, pranë Fakultetit të Mjekësisë, Administrata në Spitalin Amerikan Nr. 2</p> <p>Vlore Vlore VLORE Lagjja 15 Tetori, Rruga Mitraq Sallata, Zona Kadastrale 8601, Pasuria Nr. 2/336, Godina Nr. 1, Kati i pare</p> <p>Tirane Tirane TIRANE Njesia bashkiake nr. 6, Rruga Sabaudin Gabrani, zona 8240, Godina A, Receptioni kryesor ne Spitalin Amerikan Nr.3</p> <p>Tirane Tirane TIRANE Njesia bashkiake nr. 6, Rruga Sabaudin Gabrani, zona 8240, Godina A, Urgjenca ne Spitalin Amerikan Nr.3</p> <p>Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.11, Rr.Lord Bajron, prane S.U.T (Spitalit Ushtarak i Traumes) Poliklinika ne Spitalin Amerikan Nr.1</p> <p>Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.4, Rruga Selaudin Zorba, Banesa nr.14, Arkiva ne spitalin Amerikan nr.2</p> <p>Elbasan Elbasan ELBASAN Lagjja Kongresi i Elbasanit, Rruga Bedri Xhomo, Qender Laboratorike dhe Diagnostike</p> <p>Tirane Tirane TIRANE Njesia bashkiake nr. 6, Rruga Sabaudin Gabrani, zona 8240, Godina B, Poliklinika 3 ne Spitalin Amerikan Nr.3</p> <p>Tirane Tirane TIRANE Njesia bashkiake nr. 6, Rruga</p>
--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

